

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pa mësues për fizikë e gjeografi, nxënësit në Fushë-Kosovë humbin orë mësimore
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/pa-mesues-per-fizike-e-gjeografi-nxenesit-ne-fushe-kosove-humbin-ore-mesimore
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 00:55:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 17:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c502733bb7be10db839ae77c07b529084117126a08c870d7f9e4e14b88cd6297
TEKSTI	c801e9c338fe5d87e62ed8928226ed318689d9b0c269e27224d28de1689f85d1
PAMJA	c4d1b0268ec298e5c7ba8dfcb2af5a205eda03e29535e65a1adc0a3a4932ead8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	af690cb4e71f587afc4d28de396325ae45829706e77b47f07502c56a804021ad
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dda7d23b558402c926cd6fed567bb6eba8126329f8a189914308aeb661b57cd2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/af690cb4e71f587afc4d28de396325ae45829706e77b47f07502c56a804021ad>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Pa mësues për fizikë e gjeografi, nxënësit në Fushë-Kosovë humbin orë mësimore



Nga: Ardona Popova

23 shtator 2026 19:27

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përgjigdhura në kanalim tonë zyrtar në Viber

Disa shkolla në Komunën e Fushë-Kosovës po përballen me mungesë të mësimeve, edhe pse ka kaluar gati një muaj nga fillimi i vitit të ri shkollor. Në gjimnazin "Hivzi Sylejmani", nxënësit ende nuk i kanë zhvilluar orët e fizikës dhe gjeografisë, ndërsa në nivel komune janë hapur konkurse për 12 pozita të mësimeve. Nga Drejtoria e Arsimit thonë se mungesa e normave mësimore, por edhe rritja e numrit të nxënësve, po e vështirësojnë plotësimin e vendeve të lira

Viti i ri shkollor ka nisur me mungesë të mësimeve në gjimnazin "Hivzi Sylejmani" në Fushë-Kosovë.

Nxënësit ende nuk po zhvillojnë rregullisht mësimin në dy lëndë, fizikë dhe gjeografi, për shkak të mungesës së stafit.

"Njëra ka shkuar në pushimin e lehonisë pasi ka përfunduar viti shkollor, ndërsa mësimeve i fizikës ka shkuar në doktoratë dhe e ka liruar vendin e punës. Jemi në pritje të procedurave të konkursit. Këtë të enjte, më 24 shtator, do të mbahet intervista me gojë. Në gjeografi janë 12, ndërsa në fizikë janë 9 aplikantë", ka bërë të ditur Amir Pllana, drejtor i gjimnazit "Hivzi Sulejmani" në Fushë-Kosovë.

Arbëri.

Vuçiqi në Asambleenë e OKB-së falënderon shtetet që s'e kanë njohur Kosovën

Arbëri.

Vela e cilëson gjysmak vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Kulturë.

"Valle tradicionale të Opojës" në hap të ruajtjes së thesareve popullore

Showbiz.

Harvey Weinstein dënohet me 15 vjet burgim për sulm seksual

Basketboll.

Peja mposhtet thellë, kualifikimi thuajse i pamundur

Botë.

Zelensky në OKB: Putini është "pacienti zero", prej të cilit lufta vazhdon të përhapet

Drejtori i gjimnazit thotë se procesi i përzgjedhjes pritet të përfundojë së shpejti, në mënyrë që orët e këtyre dy lëndëve të zhvillohen rregullisht.

Por, mungesa e mësimit në këto lëndë është problem vetëm në këtë gjimnaz.

Edhe



Arbëri • 10 sht 2026

Tash e dy javë nxënësit në Lismir nuk po e vijojnë mësimin

Në Komunën e Fushë-Kosovës thonë se mungesa e kuadrit arsimor është një problem që përsëritet prej vitesh.

Drejtori i Arsimit, Sabit Xhigolli thotë se komuna përballet me mungesë të normave mësimore, ndërsa situata është vështirësuar edhe më shumë nga rritja e numrit të banorëve dhe rrjedhimisht e numrit të nxënësve.

“Siç e dini Fushë-Kosova ka vite që ballafaqohet me mungesën e normave kjo është krejt si pasojë e rritjes së popullimit në qytezën e Fushë-Kosovës, kjo tani po na sjell edhe këto pasoja. Është dashur me gjithë stafin e DKA-së të mobilizohemi dhe t’i bëjmë përgatitjet e duhura dhe të nevojshme për shpalljen e konkursit kryesisht për pozita mësimit. Një faktor që ka ndikuar në vonesën e shpalljes së konkursit është se ka dalë ideja nga zyra e kryetarit, në mungesë të normave meqë kanë qenë të lejuara diku 17 norma për administratën, të njëjtat norma t’i tjetërsojmë nëpërmjet një vendimi të asamblesë komunale nga administrata në arsim e seanca për këtë është mbajtur në fund të gushtit”, ka deklaruar Xhigolli.

Përveç fizikës dhe gjeografisë, kërkohen mësimit edhe për lëndët biologji, gjuhë shqipe, gjuhë angleze, matematikë, histori, edukatë qytetare e mësim klasor.

Sipas DKA-së, gjatë kësaj periudhe është tentuar që një pjesë e orëve të mbulohet me stafin ekzistues, por nuk është arritur të shmangen të gjitha humbjet.

Edhe



Arbëri • 5 gus 2026

43 punonjës në sektorin e arsimit në Fushë-Kosovë tash e 12 muaj pa paga

“Ka për biolog, ka për gjuhë shqipe, për gjuhë angleze, matematikë, fizikë, histori, edukatë qytetare, gjeografi, mësim klasor janë diku 12 lëndë për të cilat kemi shpallur konkurs e që ka pasur humbje gjatë kësaj periudhe ndoshta jo në shkallën e plotë, aty ku ka pasur mundësi për t’u bërë ndonjë kombinim me staf të brendshëm ju siguroj që është bërë mirëpo jo në atë shkallë të mjaftueshme sa të mos ndihen humbjet. Humbjet janë evidente por me t’i dhënë epilog këtij konkursi të gjithë ata mësimit që do të përzgjidhen, atyre do të u kërkohet që të gjitha këto orë t’i gjejnë hapësirat dhe mundësitë për t’i kompensuar”, ka thënë Xhigolli.

Në konkurs kanë aplikuar rreth 400 kandidatë, ndërsa intervistat me gojë zhvillohen të enjten.

#MUNGESE


#MESIMDHENES

#FUSHE KOSOVE

#GJEORAFI

#FIZIKE

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 13 sht 2026

14 shkolla në proces të mbylljes, shkaku i rënies së numrit të nxënësve



LAJMET E MBRËMJES • 8 sht 2026

Kosova ngel sërish në testin PISA



LAJMET E MBRËMJES • 8 sht 2026

Kosova shënon regres në testin PISA,
ekspertët kërkojnë masa urgjente

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.